REPUBLIKA E KOSOVËS / REPU
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RA
Nr. 1114/20
Datë/Datum. 25.01.2021
PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr.1114/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: Goran Milenkovic - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik N.T.SH "Atom-Med"-Ferizaj, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim emergjent me reagenca për D-Dimer" me nr. të prokurimit: 616-20-8077-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Prishtinë", më datën: 22.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.SH "Atom-Med"-Ferizaj, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim emergjent me reagenca për D-Dimer" me nr. të prokurimit 616-20-8077-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Prishtinë".

II. **ANULOHET,** njoftimi për kontratë për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim emergjent me reagenca për D-Dimer" me nr. të prokurimit: 616-20-8077-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Prishtinë", si dhe nëse AK ka interes, të njëjtin mund ta **ritenderoj.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: N.T.SH"Atom-Med"-Ferizaj, i aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues N.T.SH "Atom-Med"-Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 18.12.2020 me nr. 1114/20, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim emergjent me reagenca për D-Dimer" me nr. të prokurimit: 616-20-8077-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "KK-Prishtinë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7 dhe 51 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 4.1, 4.4, 18.9 dhe 26 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.12.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues-profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 28.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Pretendimet ankimore të OE ankues kanë të bëjnë me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit të dërguar nga AK me datë 30.11.2020.

Përgjigje në pretendimin ankimor

Pretendimi ankimor ka të bëjë me kriteret e përzgjedhjes, përkatësisht kriterin të cilin AK e ka vendosur në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit "2. Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme a) Një specialist të trajnuar për montim dhe vënie në funksion të aparaturës për D-Dimer; b) Një Inxhinier te trajnuar për servisim të aparaturës për D-Dimer" AK në dosjen e tenderit tek "Aneksi 1 - Specifikimet teknike të detyrueshme" nuk ka paraqitur të dhëna teknike, përveç deklaratës "Sipas Paramasës". Të dhënat më specifike mbi furnizimet janë gjetur tek dokumenti "Përshkrimi i Çmimeve" dhe dokumenti "Sqarimet e DT për D-Dimer" i ngritur në sistemin e E-Prokurimit nga AK me datë 03.12.2020. Në bazë të këtyre dokumenteve dhe përshkrimit të lëndës së kontratës, AK ka kërkuar që të furnizohet me "Reagjent" dhe jo ndonjë aparaturë të veçantë. Po ashtu, në dokumentet tenderike në sistemin e E-Prokurimit nuk është gjetur ndonjë kërkesë apo ndonjë pozicion i veçantë tek përshkrimi i çmimeve që kërkon shërbim shtesë për instalimin e ndonjë aparature të

veçantë apo montimin e këtyre reagjentëve në ndonjë aparaturë nga OE. Prandaj, kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe profesional të cilat janë vendosur nga AK ku kërkohet specialist dhe inxhinier për montim dhe servisim të aparaturës dhe ndërkohë lënda e kontratës, është furnizimi me reagjent dhe jo furnizim me ndonjë aparaturë përkatëse, nuk është në harmoni me Nenin 51-Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes, pika 3 e LPP-së ku thuhet se: "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse." Prandaj, pretendimi ankimor është i bazuar. Gjithsesi, rekomandohet që paneli shqyrtues të caktojë, një ekspert teknik të fushës mjekësore, në mënyrë që të shqyrtojë nëse ka ndonjë ndërlidhje eventuale të përdorimit të këtij kriteri të përzgjedhjes.

Mendimi i ekspertit shqyrtues : Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të rishikohen kriteret e përzgjedhjes dhe të jenë proporcionale me lëndën e kontratës.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 28.12.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues nuk ka kthyer përgjigje.

Operatori ekonomik N.T.SH "Atom-Med"-Ferizaj, me datë: 31.12.2021 me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën 22.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Pretendimet ankimore të OE ankues kanë të bëjnë me njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit të dërguar nga AK me datë 30.11.2020, konkretisht me kriteret e përzgjedhjes të cilin AK e ka vendosur në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit "2. Operatori ekonomike duhet te angazhoj personelin profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme a) Një specialist të trajnuar për montim dhe vënie në funksion të aparaturës për D-Dimer; b) Një Inxhinier te trajnuar për servisim të aparaturës për D-Dimer".
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK në dosjen e tenderit tek "Aneksi 1 - Specifikimet teknike të detyrueshme" nuk ka paraqitur të dhëna teknike, përveç deklaratës "Sipas Paramasës". Të dhënat më specifike mbi furnizimet janë gjetur tek dokumenti "Përshkrimi i Çmimeve" dhe dokumenti "Sqarimet e

DT për D-Dimer" i ngritur në sistemin e E-Prokurimit nga AK me datë 03.12.2020. Në bazë të këtyre dokumenteve dhe përshkrimit të lëndës së kontratës, AK ka kërkuar që të furnizohet me "Reagjent" dhe jo ndonjë aparaturë të veçantë. Po ashtu, në dokumentet tenderike në sistemin e E-Prokurimit nuk është gjetur ndonjë kërkesë apo ndonjë pozicion i veçantë tek përshkrimi i çmimeve që kërkon shërbim shtesë për instalimin e ndonjë aparature të veçantë apo montimin e këtyre reagjentëve në ndonjë aparaturë nga OE.

Prandaj, kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe profesional të cilat janë vendosur nga AK, ku kërkohet specialist dhe inxhinier për montim dhe servisim të aparaturës dhe ndërkohë lënda e kontratës është furnizimi me reagjent dhe jo furnizim me ndonjë aparaturë përkatëse, nuk është në harmoni me nenin 51-Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes, pika 3 e LPP-së ku thuhet se:

> "Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.".

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore, si dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, konsideron se autoriteti kontraktues në dosje të tenderit ka vendosur kritere të përzgjedhjes të cilat nuk janë relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e prokurimit. Andaj, AK nëse ka interes që këtë aktivitet të prokurimit ta ritenderoj, duhet që të caktoj kritereve dhe kërkesa relevante për aktivitetin e prokurimit me qëllim që të zgjerohet konkurrenca me qëllim të rritjes së ekonomicitetit dhe efikasitetit, si dhe fondet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Paneli Shqyrtues

Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KK-Prishtinë";

1x1 OE N.T.SH "Atom-Med"-Ferizaj;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.